



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 15 /2020

Ministrja e Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 3 dhe nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Nenit 6, nenit 7, 55 dhe 59 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare nr.20/21 qershor 2016), Nenit 5 (paragrafi 6) të Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë (Gazeta Zyrtare, nr.23/26 dhjetor 2018), Nenit 11 (paragrafi 1 dhe 2), Neni 15 dhe 16 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.01/2019 për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit për Noterinë, Nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019), si dhe Nenit 8 (nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse,

Ministrja e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Anulohet procesi i Provimit për Noterinë i shpallur më datë 19 prill 2019, nga Ministria e Drejtësisë.
2. Të gjitha pagesat e realizuara nga kandidatët që i janë nënshtruar provimit për noterinë sipas pikës 1, të këtij vendimi do të kthehen.
3. Obligohet Departamenti i Profesioneve të Lira dhe Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

1. Ligjit nr.06/L-010 për Noterinë, në nenin 5 par.6 përcakton se “Me akt nënligjor, të cilin e nxjerr Ministri, rregullohet mënyra e dhënies së provimit për noterinë, puna e Komisionit, programi për dhënien e provimit dhe çështje të tjera të rëndësishme për dhënien e provimit të noterisë”. Neni 6 i Ligjit për Noterinë

Ndërsa neni 7 i po këtij ligji përcakton se provimi për noterinë mbahet me shkrim dhe me gojë, në përbërje të lëndëve siç parashihet në këtë dispozitë ligjore.

2. Për zbatimin e këtyre dispozitave të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë me datë 19 prill 2019, ka publikuar shpalljen për aplikim për provim të noterisë. Më pastaj, ish-Ministri i Drejtësisë z. Abelard Tahiri ka nxjerrë Vendim nr.16/2019, të datës 19.04.2019, me të cilin është emëruar Komisioni për Dhënien e Provimit për Noterinë. Me datë 15 dhe 16 qershor 2019, është mbajtur provimi me shkrim, ndërsa më datë 6, 7 dhe 8 korrik 2019, është mbajtur provimi me gojë për noterinë.
3. Mënyra, organizimi, mbajtja dhe përfundimi i provimit të noterisë përcaktohet në nenin 5 par. 6, të Ligjit për Noterinë. Kjo dispozitë ligjore i referohet akteve nënligjore që nxjerr Ministri me qëllim të rregullimit dhe përcaktimit më të detajuar të procesit të mënyrës, organizimit dhe përfundimit të provimit të noterisë, duke përfshirë edhe lëshimin e certifikatave për kandidatë të suksesshëm, të cilët kanë dhënë provimin e noterisë.
4. Udhëzimi Administrativ MD-NR.01/2019, për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit të Noterisë, konkretisht neni 11 par.2, përcakton se **“Provimi i noterisë organizohet, mbahet dhe përfundon duke pasur për bazë parimin e ligjshmërisë, transparencës dhe objektivitetit me qëllim që të garantohet një proces i drejt”**. Parimet e përcaktuara në këtë nen janë fundamentale mbi të cilat vlerësohet procesi i dhënies së provimit të noterisë në tërësi. Ndaj, parime të tilla duhet të respektohen kumulativisht dhe cenimi i njërit apo në tërësi të këtyre parimeve konsiderohet shkelje e rëndë e procesit të Provimit të Noterisë. Kësisoj, duke marrë për bazë veprimet e Komisionit për dhënien e provimit për Noterinë, i cili ka qenë përgjegjës për hartimin e pyetjeve/testeve me shkrim dhe pyetjeve me gojë, ka rezultuar me shkelje flagrante të këtyre parimeve, për faktin se nga ky proces ka rezultuar që shumica e kandidatëve të cilët kanë dhënë provimin me shkrim dhe me gojë kanë qenë familjarë të Komisionit për dhënien e provimit për Noterinë, zyrtarë të partive në pushtet, apo familjarë të zyrtarëve të partive në pushtet, si dhe familjar të ngushtë të zyrtarëve që punojnë në sistemin e drejtësisë. Paligjshmëria si dukuri normative fillon me cenimin e nenit 15 par.1, të Udhëzimit Administrativ MD. Nr 01/2019, për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit për Noterinë, i cili përcakton se *“Provimi me shkrim mbahet në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët”*. Në kundërshtim me këtë dispozitë të aktit nënligjor, provimi i noterisë ka zgjatur më shumë se një ditë, në kuptim të planifikimit, dhe mënyrës së ekzekutimit të procedurës së mbajtjes së provimit të noterisë, për ti identifikuar dhe kaluar nga provimi me shkrim kandidatë në numër shqetësues, në lidhje politike, shoqërore dhe familjare. Dëmtimi i integritetit të procesit të dhënies së provimit të noterisë, vazhdon edhe në monitorimin sallave të provimit. Në lidhje me këtë neni 16, i këtij udhëzimi Administrativ përcakton qartë së monitorimi i sallave të provimit behët nga Staf i Departamentit të Profesioneve të Lira me qëllim

të mbarëvajtjes së provimit dhe eliminimin e keqpërdorimeve eventuale nga ana e kandidatëve (...). Në kundërshtim këtë dispozitë të aktit juridik nënligjor, Komisioni përkatës ka bërë monitorimin e sallave të provimit për noterë.

5. Raporti i cili është krijuar kundërligjshëm ndërmjet personave zyrtarë përgjegjës, të cilët ishin obliguar në respektim të parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe objektivitetit gjatë procesit të provimit të noterisë, ka pasur për qëllim që të vendosen noter me vula familjare, miqësore apo partiake, duke rezultuar me shkelje të këtyre parimeve të cilat rrjedhin nga Kushtetuta e Kosovës dhe ligje të cilat rregullojnë veprimtarinë dhe funksionimin e administratës shtetërore. Në lidhje me këtë, Kushtetua e Kosovës, në nenin 3 par. 2 përcakton se “*Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre*” Ndërsa në nenin 24 par. 1 përcakton se “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*”. Gjithashtu në paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se “*Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal*”. Këto dispozita kushtetuese garantojnë barazinë para ligjit të të gjithë individëve dhe mosdiskriminimin e tyre në raport përkatësinë dhe me mendimet e tyre politike, gjinisë gjuhës apo fesë etj. Koncepti i barazisë para ligjit është një ndër parimet kryesore të sundimit të ligjit. Kjo e drejtë përfshin trajtimin e barabartë të palëve nga ana e institucioneve dhe gjykatave. Pra, çdo subjekt juridik apo fizik duhet të trajtohet pa diskriminim dhe njëjtë sikurse palët e tjera sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. E drejta e barazisë përpara ligjit, ose siç thuhet shpesh, mbrojtja e njëllotë nga ligji, përbën themelin e një shoqërie të drejtë e demokratike. Thelbi i administrimit të përditshëm gjyqësor dhe institucional konsiston në premtimin për një drejtësi të barabartë përpara ligjit dhe në garancitë kushtetuese të mbrojtjes, për proces ligjor të rregullt. Barazia apo të qenit i barabartë, është simbol dhe nxitje që njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa privilegje. Nga kjo, argumentohet qartë se ka pasur trajtim të ndryshëm, konkretisht diskriminues pa arsytim objektiv dhe racional ndaj personave që nuk kanë pasur [...] lidhje familjare, miqësore apo politike në situata relativisht të ngjashme (*Shih: Willis V Mbreterise se Bashkuar, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 11 shtatorit 2002; Bekos dhe Koutropoulos V Greqise, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 13 Marsit 2006*).

Kësisoj, parimi i objektivitetit (paanësisë) dhe parimi i mosdiskriminimit në raport me kandidatë tjerë, janë cenuar nga ana e Komisionit për dhënien e provimit për Noterinë. Andaj, ky Komision ka bërë shkelje të nenit 6 dhe 7, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 11 par. 2, të Udhëzimit Administrativ MD-NR.01/2019, për Mënyrën e Dhënies dhe Programin e Provimit të Noterisë, dhe rrjedhimisht ka cenuar nenin 3 dhe 24 të Kushtetutës së Kosovës, për shkak mënyrës së mbajtjes, organizimit dhe

përfundimit të provimit të noterisë, i cili proces ka prodhuar kandidatë të “suksesshëm” në numër shqetësues, me lidhje familjare, miqësore dhe partiake, të cilët kanë mundur të ushtrojnë profesionin e noterit në dëm të interesit të përgjithshëm publik, dhe në dëm të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Komisioni për dhënien e provimit të noterisë, për të mos u mjaftuar me kaq, ka cenuar parimin tjetër, pra parimin e ligjshmërisë.

Neni 4 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton qartë se *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca”*. Ligji për Noterinë dhe aktet nënligjore obligojnë Komisionin për dhënien e provimit të Noterisë që të veprojë në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat ligjore në respektim të parimeve të lartcekura që sigurojnë legalitetin dhe legjitimitetin procesit të provimit të Noterisë. Mirëpo, marrëveshjet kundërligjore të Komisionit për dhënien e provimit për Noterinë për t’i shtyrë (favorizuar) në rrugë jo ligjore dhe kushtetuese persona të caktuar, në numër tejet të madh, për tu zgjedhur “Noter” mbi baza familjare miqësore dhe partiake, ka bërë që të cenohet neni 4, i ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe neni 7, i Kushtetutës së Kosovës, që lidhet me parimet mbi të cilat ndërtohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.

6. Raporti i Komisionit për dhënien e provimit për Noterinë me transparencën gjatë procesit të provimit të Noterisë ka qenë në nivel shqetësues. Krejt kjo për faktin se mos transparenca është element i rëndësishëm për t’i shtuar format e marrëveshjeve kundërligjore për të favorizuar persona të caktuar drejtë zgjedhjes së tyre si “Noter” dhe eliminuar persona të tjerë që nuk kanë lidhje familjare, miqësore apo partiake. Pra, në argumentim më të thelluar të këtij veprimi kundërligjor, mund të provojmë një formë tjetër korruptive, të bërë nga anëtarët e Komisionit për dhënien e Provimit të Noterisë. Kësisoj, njëri nga anëtarët e Komisionit përkatës përmes procesverbaleve ka deklaruar se anëtari i këtij komisioni mund të ketë konflikt interesi me 7 persona, ndërsa, në anën tjetër, të gjithë këta persona kanë kaluar provimin e noterisë pa një monitorim të theksuar nga aktor e faktor të caktuar. Po ashtu, këtë shembull korruptues të shndërruar në veprim kundërligjor e kanë ndjekur edhe anëtar të tjerë të këtij komisioni, që kanë deklaruar në procesverbale që mund të kenë konflikt interesi me persona të caktuar, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër, të gjithë këta kandidatë pa përjashtim kanë kaluar provimin e noterisë. Ndaj, kjo provon faktin e parrëzueshëm për marrëveshjen kundërligjore ndërmjet anëtarëve të Komisionit dhe nivelit të transparencës gjatë procesit të provimit të noterisë, i cili konsiderohet proces i korruptuar dhe i degraduar skajshmërisht. Më tej, anëtarët e komisionit pavarësisht deklarimit të shprehur se mund të ndodhen në konflikt interesi, kanë hartuar pyetjet për provimin me shkrim të noterisë. Ky veprim i anëtarëve të Komisionit përkatës, paraqet argument shtesë për parregullsinë dhe paligjshmërinë e këtij procesi.

Kundërligjshmëria e këtij komisioni vazhdon edhe me plotësimin kërkesave të miqve, familjareve dhe zyrtarëve partiak për t’i akomoduar persona të shumtë si ushtrues të profesionit të “Noterit”, larg parimit të transparencës, konkretisht në kundërshtim me nenin 9, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

7. Prandaj për shkak të veprimeve kundërligjore dhe kundër-kushtetuese në mënyrë të organizuar nga Komisioni për dhënien e provimit për Noterinë në bashkëpunim me zyrtarë shtetëror partiak, miq dhe familjarë për t'i përzgjedhur personat në grupe të caktuara si "Noterë" të ardhshëm, kanë pasuar reagime të ndryshme, përfshirë edhe institucione relevante ndërkombëtare dhe evropiane që merren me këtë fushë. Për më tepër, me datë 06 shkurt 2020, Ministria e Drejtësisë, ka pranuar një letër nga Oda Federale Gjermane e Noterisë së bashku me Unionin Ndërkombëtar të Noterëve (UNN) në të cilën potencohet përfshirja aktive e këtyre mekanizmave në parandalimin e emërimit të noterëve të rinj, që do të mund të dalin nga ky proces i kompromentuar.
8. Anulimi i procesit të provimit për Noterinë dhe veprimeve të mëtejme behet në përputhje me nenin 55 par.1, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se *"Një akt administrativ i paligjshëm për arsye të tjera nga ato ta parapara nga neni 54 i këtij Ligji, mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllimin për të vendosur ligjshmërinë"*. Gjithashtu, anulimi i provimit të noterisë është në dobi të interesit përgjithshëm, dhe në kompatibilitet me rendin publik, për faktin se procesi ka qenë kundërligjor dhe kundër-kushtetues, duke shkelur parime themelore të përcaktuar në pikat e lartcekura, pas së cilës ka pasuar reagime publike në formë të shkruar në nivel lokal dhe ndërkombëtar për mosnjohjen e akteve noteriale nga vendet e BE-së, veprime eventuale këto, që bien ndesh me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 06/L-010, për Noterinë për njohjen e akteve noteriale.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Prishtinë, më 21. 02. 2020

Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

